



# ProPack sh.p.k

---

**Forma juridike: Shoqëri me Pëgjegjesi të Kufizuar**

**Data e themelimit: 24.01.2018**

**Numri unik i indentifikimit(NIPT): L83730401V**

**Selia: Fier i Ri, Krutje, zona kadastrale 1614, Lushnje**

**Objekti tregtar: Tregtim materialeve te ndryshme import-eksport,  
perpunim dhe montim te tabakeve te kartonit**

## **Pasqyrat Financiare Vjetore** **2021**

**(Mbyllur më 31.12.2021)**

**Pasqyra financiare: Individuale(jokonsoliduara)**  
**Periudha kontabel: Nga 01.01.2021 deri më 31.12.2021**  
**Data e mbylljes: 25.03.2022**  
**Monedha: Leke**  
**Shkalla e rrumbullakimit: ne leke**

**Lushnjë, Mars 2022**

## TABELA E PËRMBAJTJES

A. PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR(BILANCI).....	2-3
AKTIVI .....	2
DETYRIME DHE KAPITALI.....	3
B. PASQYRA E PERFORMANCES .....	4-5
PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE .....	4
PASQYRA E TE ARDHURAVE GJITHEPERFSHIRESE .....	5
C. PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE.....	6
D. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO.....	7
E. SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE .....	8-16

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR(BILANCI)  
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2021  
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Shënime	Viti Raportues 31.12.2021	Viti Paraardhës 31.12.2020
<b>A</b>	<b>AKTIVI</b>			
<b>I</b>	<b>Aktive Afatshkurtra</b>			
1	Mjete Monetare	5	14,784,441	9,797,663
2	Investime (Tituj Pronësie të Njësive Brenda Grupit, Aksior		-	-
3	Të Drejta të Arkëtueshme	6		
	Nga Aktiviteti i Shfrytëzimit (Klientë)		36,751,160	44,617,666
	Njesitë Ekonomike Brenda Grupit		-	-
	Interesa Pjesëmarrëse në Njesi Ekonomike		-	-
	Të Tjera (Debitore të tjerë)		2,442,163	3,942,019
	Kapital i Nënshkruar i Papaguar		-	-
	<b>Totali i të Drejtave të Arkëtueshme (3)</b>		<b>39,193,323</b>	<b>48,559,685</b>
4	inventarët:	7		
	Lënde e Parë dhe Materiale të Konsumueshme		-	2,771,536
	Prodhime në Proces dhe Gjysëmprodukte		-	-
	Produkte të Gatshme		-	-
	Mallra		-	-
	Aktive Biologjike		-	-
	AAM të Mbajtura për Shitje		-	-
	Parapagime për Inventar		-	-
	<b>Totali i Inventarit (4)</b>		<b>-</b>	<b>2,771,536</b>
5	Shpenzime të Shtyra	8	-	-
6	Të Arkëtueshme nga të Ardhurat e Konstatuara		-	-
	<b>Totali i Aktiveve Afatshkurtra (I)</b>		<b>53,977,764</b>	<b>61,128,884</b>
<b>II</b>	<b>Aktive Afatgjata</b>			
1	Aktive Financiare		-	-
	Tituj Pronësie në Njs. Ekon. Brenda Grupit		-	-
	Tituj Huadhënieje në Njes. Ekon. Brenda Grupit		-	-
	Tituj Pronësie në Njs.Ekon. Pjesëmarrje		-	-
	Tituj Huadhënieje në Njës. Ekon. Pjesëmarrjeje		-	-
	Tituj të Tjerë (Aktive Afatgjata)		-	-
	Tituj të Tjere të Huadhënies		-	-
	<b>Totali i Aktiveve Financiare (1)</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
2	Aktive Materiale	9		
	Toka dhe Ndërtesa		-	-
	Impiante dhe Makineri		-	-
	Të Tjera Instalime dhe Pajisje		245,700	464,916
	Parapagime për Aktive Materiale dhe në Proces		-	-
	<b>Totali i Aktiveve Materiale (2)</b>		<b>245,700</b>	<b>464,916</b>
3	Aktive Biologjike		-	-
4	Aktive Jo-Materiale		-	-
	Koncesione, Patenta, Licenca, Marka Tregtare		-	-
	Emri i Mirë		-	-
	Parapagime për Aktive Afatgjata Jo Materiale		-	-
	<b>Totali i Aktiveve Jo-Materiale (4)</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
5	Aktive Tatimore të Shtyra		-	-
	<b>Totali i Aktiveve Afatgjata (II)</b>		<b>245,700</b>	<b>464,916</b>
	<b>TOTALI I AKTIVEVE (I+II)</b>		<b>54,223,464</b>	<b>61,593,800</b>

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR(BILANCI)-VAZHDIM  
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2021  
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Shënime	Viti Raportues 31.12.2021	Viti Paraardhës 31.12.2020
<b>B</b>	<b>DETYRIMET DHE KAPITALI</b>			
<b>I</b>	<b>Detyrime Afatshkurtra</b>	<b>10</b>		
	Titujt e Huamarrjes		-	-
	Detyrime ndaj Institucioneve të Kredisë		-	-
	Arkëtime në Avancë për Porosi		-	-
	Të Pagueshme për Aktivitetin e Shfrytëzimit (Furnitore)		9,444,875	4,594,200
	Dëftesa të Pagueshme		-	-
	Të Pagueshme ndaj Njës.Ekon. Grup		-	-
	Të Pagueshme ndaj Njës.Ekon. Pjesëmarrje		-	-
	Të Pagueshme ndaj Punonjësve dhe Sigurime Shoq./Shëi		1,191,942	656,199
	Të Pagueshme për Detyrime Tatimore		1,950	1,163,590
	Të Tjera të Pagueshme		29,675,516	29,772,250
	<b>Totali i Detyrimeve Afatshkurtra (I.1)</b>		<b>40,314,283</b>	<b>36,186,239</b>
	2 Të Pagueshme për Shpenzime të Konstatuara		-	-
	3 Të Ardhura të Shtyra dhe Grantet		-	-
	4 Provizionet		-	-
	<b>Totali i Detyrimeve Afatshkurtra (I.1+I.2+I.3+I.4)</b>		<b>40,314,283</b>	<b>36,186,239</b>
<b>II</b>	<b>Detyrimet Afatgjata</b>	<b>11</b>		
	Titujt e Huamarrjes		-	-
	Detyrime ndaj Institucioneve të Kredisë		-	-
	Arkëtime në Avancë për Porosi		-	-
	Të Pagueshme për Aktivitet Shfrytëzuese (Furnitore)		-	-
	Dëftesa të Pagueshme		-	-
	Të Pagueshme Ndaj Njës.Ekon. Grup		-	-
	Të Pagueshme Ndaj Njës.Ekon. Pjesëmarrje		-	-
	Të Tjera të Pagueshme		-	-
	<b>Totali i Detyrimeve Afatgjata (II.1)</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
	2 Të Pagueshme për Shpenzime të Konstatuara		-	-
	3 Të Ardhura të Shtyra		-	-
	4 Provizione (Pensione, Te Tjera)		-	-
	5 Detyrime Tatimore të Shtyra		-	-
	<b>Totali i Detyrimeve Afatgjata (II.1+II.2+II.3+II.4+II.5)</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
	<b>TOTALI I DETYRIMEVE (I+II)</b>		<b>40,314,283</b>	<b>36,186,239</b>
<b>III</b>	<b>Kapitali dhe Rezervat</b>	<b>12</b>		
	1 Kapitali i Nënshkruar		1,000,000	1,000,000
	2 Primi i Lidhur me Kapitalin (-)		-	-
	3 Rezerva Rivlerësimi		-	-
	4 Rezerva të tjera		-	-
	Rezerva Ligjore		-	-
	Rezerva Statutore		-	-
	Rezerva të Tjera		14,407,561	21,850,905
	5 Fitimi i Pashpërndarë		-	-
	6 Fitimi (Humbja) e Vitit Financiar		(1,498,380)	2,556,656
	<b>Totali i Kapitalit dhe Rezervave (III)</b>		<b>13,909,181</b>	<b>25,407,561</b>
	<b>TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT NETO</b>		<b>54,223,464</b>	<b>61,593,800</b>

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërese e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E PERFORMANCËS  
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2021  
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)

A. Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve  
(Shpenzimet e shfrytëzimit të klasifikuara sipas natyrës)

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Shënime	Viti Raportues 31.12.2021	Viti Paraardhës 31.12.2020
1	<b>Të Ardhura nga Aktiviteti i Shfrytëzimit</b>	13	5,981,750	101,282,960
2	<b>Ndryshimi në Inventarin e PG&amp;PP</b>		-	-
3	<b>Puna e Kryer nga Nj.E dhe e Kapitalizuar</b>		-	-
4	<b>Të Ardhura të Tjera të Shfrytëzimit</b>		-	-
5	<b>Lënda e Parë dhe Materiale të Konsumueshme</b>	14		
	Lënda e Parë dhe Materiale të Konsumueshme		(5,037,771)	(81,098,515)
	Të Tjera Shpenzime		-	-
6	<b>Shpenzime Personell</b>	15		
	Paga dhe Shpërblime		(1,007,216)	(3,454,713)
	Shpenzime për Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore		(168,205)	(576,937)
7	<b>Zhvierësimi i Aktiveve Afatgjata Materiale</b>	9	-	-
8	<b>Shpenzime Konsumi dhe Amortizimi</b>	9	(74,030)	(1,055,620)
9	<b>Shpenzime të Tjera Shfrytëzimi</b>	16	(1,522,547)	(11,776,160)
10	<b>Totali i Shpenzimeve (5-9)</b>		<b>(7,809,769)</b>	<b>(97,961,945)</b>
11	<b>Fitimi (Humbja) nga Aktiviteti i Shfrytëzimit (1-9)</b>		<b>(1,828,019)</b>	<b>3,321,015</b>
12	<b>Të Ardhura të Tjera</b>			
	Të Ardhura nga Aktiviteti Pjesëmarrës në Njesi të Tjera Eko		-	-
	Të Ardhura Nga Investimet dhe Huatë e Tjera		-	-
	Interesa të Arketueshem dhe të Ardhura të Tjera të Ngjashm		329,639	191
	<b>Totali i Të Ardhurave të Tjera (12)</b>		<b>329,639</b>	<b>191</b>
13	<b>Zhvierësimi i Aktiveve dhe Invest. Financiare (AASH)</b>		-	-
14	<b>Shpenzime Financiare</b>	17		
	Shpenzime Interesi dhe Shpenzime të Ngjashme		-	-
	Shpenzimet e Tjera Financiare		-	(293,821)
	<b>Totali i Shpenzimeve Financiare(14)</b>		<b>-</b>	<b>(293,821)</b>
15	<b>Pjesa e Fitimit/(Humbjes) nga Pjesëmarrja</b>		-	-
16	<b>Fitimi/(Humbja) Para Tatimit (11-15)</b>		<b>(1,498,380)</b>	<b>3,027,385</b>
17	<b>Shpenzime (Të Ardhura) për Tatimin mbi Fitimin</b>	18		
	Shpenzimi Aktual i Tatimit mbi Fitimin		-	(470,729)
	Shpenzime (Të Ardhura) i Tatim Fitimit të Shtyrë		-	-
	Pjesa e Tatim Fitimit të Pjesëmarrjeve		-	-
18	<b>Fitimi/(Humbja) e Vitit Financiar (16-17)</b>		<b>(1,498,380)</b>	<b>2,556,656</b>
19	<b>Fitimi/(Humbja) Për:</b>			
	Pronarët e Njesisë Ekonomike Mëmë		-	-
	Interesat Jo-Kontrolluese		-	-

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E PERFORMANCËS-VAZHDIM  
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2021  
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)

B.Pasqyra e të ardhurave gjithpërfshirëse

Nr	Përshkrimi i Elementeve	Shënime	Viti Raportues 31.12.2021	Viti Paraardhës 31.12.2020
<b>1</b>	<b>Fitimi/(Humbja) e Vitit Financiar</b>		(1,498,380)	2,556,656
2	Diferencat nga Përkth. i Monedhes në Veprimt. të Huaja	.	-	-
3	Diferencat nga Rivleresimi i Aktiveve Afatgjata Materiale	.	-	-
4	Diferencat nga Rivleresimi i Aktiveve Fin. të Mbaj. Shitje	.	-	-
5	Pjesa e të Ardhurave Gjithëpërfsh. nga Pjesëmarrjet	.	-	-
6	Të Tjera të Ardhura Gjithëpërfshirëse për Vitin	.	-	-
<b>7</b>	<b>Totali i të Ardhurave Gjithëpërfsh. për Vitin (2-6)</b>		-	-
	<b>Totali i të Ardhurave/(Humbjeve) Gjithëpërfshirëse (1+/-7)</b>		<b>(1,498,380)</b>	<b>2,556,656</b>
	Pronarët e Njesise Mëmë		-	-
	Interesat Jo-Kontrolluese		-	-

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërese e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE (METODA INDIREKTE)  
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2021  
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)

Nr	Pershkrimi i Elementeve	Shënimet	Viti Raportues 31.12.2021	Viti Paraardhës 31.12.2020
<b>I</b>	<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga Aktiv. Shfrytëzimit</b>			
	<b>Fitimi/(Humbja) e Vitit Financiar</b>		<b>(1,498,380)</b>	<b>2,556,656</b>
	Rregullimet për Shpenzimet Jomonetare:			
	Shpenzime Financiare Jo-Monetare		-	-
	Shpenzime për Tatimin mbi Fitimin Jo-Monetar		250,822	4,358,565
	Shpenzime Konsumi dhe Amortizimi		74,030	1,055,620
	Zhvierësimi i Aktiveve Afatgjata Materiale		-	-
	Fitimi nga Shitja e Aktiveve Afatgjata Materiale (Fluksi i P		(283,914)	60,241
	<b>Ndryshimet në Aktivet dhe Detyrimet e Shfrytëzimit</b>			
	Rritje/Rënie në të Drejtat e Arketueshme dhe të Tjera		9,366,362	(206,368)
	Rritje/Rënie në Inventarë		2,771,536	18,974,117
	Rritje/Rënie në Detyrimet e Pagueshme		3,341,479	(34,922,237)
	Rritje/Rënie në Detyrimet ndaj Punonjësve		535,743	172,319
	<b>Mjete Monetare Neto nga Aktiv. e Shfrytëzimit</b>		<b>14,557,678</b>	<b>(7,951,087)</b>
<b>II</b>	<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga Aktiv. Investimit</b>			
	Para Neto të Perdorura për Blerjen e Filialeve		-	-
	Para Neto të Arketuara nga Shitja e Filialeve		-	-
	Pagesa për Blerjen e Aktiveve Afatgjata Materiale		-	(434,830)
	Arketime nga Shitja e Aktiveve Afatgjata Materiale		429,100	6,914,305
	Pagesa për Blerjen e Investimeve të Tjera		-	-
	Arketime nga Shitja e Investimeve të Tjera		-	-
	Dividende të Arketuar		(10,000,000)	-
	<b>Mjete Monetare Neto nga Aktiv. e Investimit</b>		<b>(9,570,900)</b>	<b>6,479,475</b>
<b>III</b>	<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga Aktiv. Financimit</b>			
	Arketime nga Emetimi i Kapitalit Aksionar		-	-
	Arketime nga Emetimi i Aksioneve të Perdorura si Kolateral		-	-
	Hua të Arketuara		-	-
	Pagesa e kostove transaksionale (Hua dhe Kredi)		-	-
	Riblerje e Aksioneve të Veta		-	-
	Pagesa e Aksioneve të Perdorura si Kolateral		-	-
	Pagesa e Huave		-	-
	Pagese e Detyrimeve prej Qirase Financiare		-	-
	Interes i Paguar		-	-
	Dividende të Paguar		-	-
	<b>Mjete monetare Neto nga Aktiv. e Financimit</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>IV</b>	<b>Rritje/Rënie Neto në Mjetet Monetare dhe Ekuivalente</b>		<b>4,986,778</b>	<b>(1,471,612)</b>
	<b>Mjetet Monetare dhe Ekuivalentet në Fillim të Periudhës</b>		<b>9,797,663</b>	<b>11,269,275</b>
	<b>Efkti i Lulatjeve të Kursit të Këmbimit</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
	<b>Mjetet Monetare dhe Ekuivalentet në Fund të Periudhës</b>		<b>14,784,441</b>	<b>9,797,663</b>

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërese e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL  
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2021  
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Kapitali i Nënshkruar	Primi i Lidhur me Kapitalin	Rezerva Rivlerësimi	Rezerva Ligjore Rezerva Statutore & të Tjera	Fitimet e Pashpërdara	Fitimi / Humbja e vitit	Totali
A	<b>Pozicioni Financiar më 31 Dhjetor 2019</b>	1,000,000	-	-	4,795,348	-	17,055,557	22,850,905
	Efekti i Ndryshimeve në Politikat Kontabël	-	-	-	-	-	-	-
	<b>Pozicioni Financiar i Rideklaruar më 1 Janar 2020</b>	1,000,000	-	-	4,795,348	-	17,055,557	22,850,905
	<b>Të Ardhura Totale Gjithëpërfshirëse për 1 Vitin:</b>							
	Fitimi / Humbja e Vitit	-	-	-	-	-	2,556,656	2,556,656
	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-	-	-
	<b>Totali i të Ardhurave Gjithëpërfshirëse për Vitin:</b>	-	-	-	-	-	2,556,656	2,556,656
	<b>Transaksionet me Pronarët e Njesisë</b>							
	<b>2 Ekonomike të Njohura Direkt në Kapital:</b>							
	Emetimi i Kapitalit të Nënshkruar (+Ndryshimet Brenda Zerave)	-	-	-	17,055,557	-	(17,055,557)	-
	Dividendë të Paguar	-	-	-	-	-	-	-
	<b>Totali i Transaksioneve me Pronarët e Njesisë Ekonomike</b>	-	-	-	17,055,557	-	(17,055,557)	-
B	<b>Pozicioni Financiar më 31 Dhjetor 2020</b>	1,000,000	-	-	21,850,905	-	2,556,656	25,407,561
	Efekti i Ndryshimeve në Politikat Kontabël	-	-	-	-	-	-	-
	<b>Pozicioni Financiar i Rideklaruar më 1 Janar 2021</b>	1,000,000	-	-	21,850,905	-	2,556,656	25,407,561
	<b>Të Ardhura Totale Gjithëpërfshirëse për 1 Vitin:</b>							
	Fitimi / Humbja e Vitit	-	-	-	-	-	(1,498,380)	(1,498,380)
	Të Ardhura të Tjera Gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-	-	-
	<b>Totali i të Ardhurave Gjithëpërfshirëse për Vitin:</b>	-	-	-	-	-	(1,498,380)	(1,498,380)
	<b>Transaksionet me Pronarët e Njesisë</b>							
	<b>2 Ekonomike të Njohura Direkt në Kapital:</b>							
	Emetimi i Kapitalit të Nënshkruar (+ Ndryshimet Brenda Zerave)	-	-	-	2,556,656	-	(2,556,656)	-
	Dividendë të Paguar	-	-	-	(10,000,000)	-	-	(10,000,000)
	<b>Totali i Transaksioneve me Pronarët e Njesisë Ekonomike</b>	-	-	-	(7,443,344)	-	(2,556,656)	(10,000,000)
C	<b>Pozicioni Financiar më 31 Dhjetor 2021</b>	1,000,000	-	-	14,407,561	-	(1,498,380)	13,909,181

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare. Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtimi i “ProPack” SH.P.K. dhe janë fimosur nga:

Përfaqësuesi Ligjor

Ilirjan MEÇI

SHPK PROPACK  
L83730401V  
LUSHNJE  
ALBANIA

Nipt: L83730401V



Martuesi/Financieri

Aqif TOSKA



**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE  
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2021  
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)**

**1. Informacione te pergjitheshme**

Shoqëria tregtare “ProPack” shpk, eshte themeluar si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar më 24 janar 2018 dhe vepron në përputhje me ligjin “Për tregtarë dhe shoqëritë tregtare” dhe ligjeve të tjera që rregullojnë biznesin në Shqipëri. Kapitali i rregjistruar është 1.000.000 leke dhe zoterohet nga ortakët e shoqërisë z.Illirjan Meçi me 51% te kapitali dhe z. Armand Meçi me 49% te kapitalit. Veprimtaria kryesore e shoqërisë për ushtrimin 2021 ka qënë tregtimi i materialeve te ndryshme perpunim e montim te tabakeve te kartonit.

**2. Deklaratë e pajtueshmërisë me SKK-të**

Pasqyrat financiare(indivuale) për qëllime të përgjithshme janë përgatitur dhe paraqiten në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit(SKK-të), të përmirësuara, dhe me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

**Përmbledhje e politikave kontabël të rëndësishme të zbatuara****3. Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare**

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera, dhe parimit të drejtave të kostatuara. Ato paraqiten në monedhën vendase, Lekë Shqiptar (“lekë”).

**4. Politikat më të rëndësishme kontabël të zbatuara:****4.1 Mjetet monetare**

Mjetet monetare përfshijnë, mjete monetare në arkë dhe bankë, llogari rrjedhëse, si dhe, investime në tregun e parasë dhe tregje të tjera shumë likuide me kontrata jo më të gjata se tre muaj, të cilat janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë.

Flukset monetare janë hyrjet ose daljet e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare.

Veprimtari të shfrytëzimit janë aktivitetet bazë të prodhimit të të ardhurave të shoqërisë dhe aktivitetet të tjera të cilat nuk janë aktivitetet investuese ose financuese.

Veprimtari investuese janë blerja, dhe nxjerrja e aktiveve afatgjata dhe investime të tjera që nuk përfshihen në ekuivalentët e mjeteve monetare.

Aktivitetet financuese janë aktivitetet që çojnë në ndryshime në masën dhe përbërjen e kapitalit neto të kontribuar dhe të huasë të shoqërisë.

**4.2 Aktivitet dhe detyrimet financiare**

Një aktiv financiar ose një detyrim financiar njihet vetëm kur shoqëria bëhet pjesë e kushteve kontraktuale të instrumentit. Matja fillestare e një aktivi financiar ose një detyrim financiar bëhet me kostot e transaksionit (duke përfshirë edhe çmimin e transaksionit) përveç rasteve kur marrëveshja përbën në thelb, një transaksion financiar. Një transaksion financiar mund të jetë, për shembull, kur shiten mallra apo shërbime dhe kur pagesa shtyhet përtej afateve normale të tregtisë ose kur ajo është financuar me një normë interesi që nuk është një normë tregu. Nëse marrëveshja përbën një transaksion financiar, matja e aktivitetit financiar ose detyrimit financiar bëhet me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me normën e interesit të tregut për një instrument të ngjashëm borxhi.

Në fund të periudhës raportuese, matja e instrumentave financiarë bëhet si vijon: Instrumentat e borxhit e percaktuara në pikën 7 dhe 8 të SKK-3 (si llogari, dëftesë ose hua e arkëtueshme ose e pagueshme) maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Instrumentat e borxhit që janë të klasifikuara si aktive afatshkurtër ose detyrime afatshkurtër maten me shumën e paskontuar të mjeteve monetare ose shumave

të tjera të pritshme për t'u paguar ose arkëtuar, përveçse kur marrëveshja përbën, në efekt, një transaksion financiar. Nëse marrëveshja përbën një transaksion financiar, matja e instrumentit të borxhit bëhet me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me një normë tregu interesi për një instrument të ngjashëm borxhi.

Në fund të çdo periudhe raportimi, shoqëria vlerëson nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit të ndonjë aktivi financiar që matet me kosto ose me kosto të amortizuar. Nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit, njihen menjëherë shumat për humbje nga zhvlerësimi në fitim ose humbje.

Nëse, në një periudhë pasuese, shumata e humbjes nga zhvlerësimi zvogëlohet dhe zvogëlimi mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi ishte njohur zhvlerësimi (si një përmirësim në vlerësimin e pozicionit financiar të debitorit), rimerret humbja nga zhvlerësimi të njohur më parë ose direkt ose duke rregulluar një llogari zhvlerësimi, në fitim ose humbje.

Aktivitetet dhe detyrimet financiarë shoqëria i klasifikon në afatshkurtra dhe afatgjata, bazuar në përcaktimet e SKK-2.

#### **4.3 Inventarët**

Fillimisht, inventari njihet atëherë kur shoqëria e ka nën kontroll, pret përfitime ekonomike prej tij dhe kostoja e tij mund të vlerësohet me besueshmëri. Njohja e inventarëve bëhet zakonisht në momentin e përfitimit.

Inventarët maten fillimisht me kosto. Kostoja e inventarit përfshin: koston e të gjitha materialeve të lidhura drejtpërdrejt me prodhimin si dhe koston e shndërrimit të këtyre materialeve në produkte përfundimtare. Kostot e drejtpërdrejta të materialeve përfshijnë, përveç çmimit të blerjes, edhe të gjitha kostot e tjera që nevojiten për të sjellë inventarin në gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese.

Kostoja e lëndëve të para, materialeve të konsumit, tokës dhe ndërtesave të blera për rishitje, përbëhet nga çmimi i blerjes, shpenzimet e transportit, taksat e importit, magazinimi, zbritjet dhe shtesat tregtare dhe të tjera shpenzime të tjera të ngjashme (taksat e parimbursueshme).

Pas njohjes, inventari matet me vlerën më të ulët midis koston dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me koston për t'u përfunduar dhe shitur.

Inventarët i nënshtrohen testit të zhvlerësimit në datën e raportimit.

#### **4.4 Shpenzimet e shtyra dhe të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara**

Shoqëria zbaton politikën e shtyrjes të shpenzimeve të cilat do të sigurojnë të ardhura në periudhat e mëvonshme. Po ashtu ajo shpërndan shpenzimet e parapaguara në vartësi të përdorimit dhe sigurimit të të ardhurave.

#### **4.5 Aktivitetet afatgjata materiale**

Aktivitetet afatgjata materiale (AAM-të) njihen si një aktiv vetëm nëse: aktiviteti kontrollohet nga shoqëria, është e mundur që përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i aktivitetit të hyrë dhe kostoja e aktivitetit mund të matet me besueshmëri. Regjistrimi fillestar i AAM-së bëhet zakonisht në momentin e përfitimit të tij nga blerja apo prodhimi. Një element i AAM-së, që plotëson kriteret për njohje si aktiv në pasqyrën e pozicionit financiar, matet me kosto. Në vlerësimin e mëpasshëm shoqëria zbaton si politikë të saj kontabël modelin e koston dhe e aplikon këtë model për të gjithë klasën e AAM-së që vlerësohet.

Në pasqyrën e pozicionit financiar një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostot që kanë të bëjnë me përmirësimet e mëpasshme i shtohen koston së AAM-së vetëm nëse ato pëmbushin kriteret e përkufizimit të AAM-ve dhe kriteret për njohjen e aktiveve në pasqyrën e pozicionit financiar. Kostot që lidhen me mirëmbajtjet dhe riparimet e vazhdueshme njihen si shpenzime gjatë vitit ushtrimor.

Shoqëria vlerëson në çdo datë të raportimit nëse ka ndonjë shenjë që një aktiv mund të jetë i zhvlerësuar. Nëse ekziston ndonjë shenjë e tillë, ajo vlerëson shumën e rikuperueshme të aktivitetit. Nëse nuk ka të shenja për zhvlerësim, nuk është e nevojshme të vlerësohet shumata e rikuperueshme. Vlera e amortizueshme e AAM-ve njihet në pasqyrën e të ardhurave, si shpenzim në mënyrë sistematike përgjatë jetës së dobishme të këtij aktivi. Përfundime bëjnë aktivitetet afatgjata materiale me jetë të dobishme pa afat si për shembull, toka (përveç minierave dhe vendeve të përdorura për groposje), punimet e artit me jetë afatgjatë, veprat e muzeve dhe librat të cilat nuk amortizohen.

Amortizimi për të gjitha grupet, llogaritet dhe njihet me *metodën e vlerës së mbetur*, me norma të cilat janë të përafërta me jetegjatesinë mesatare të parashikuar të përdorimit. Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen. Normat e perdorura janë në ndërtesa 5 % të dhe për aktivet e tjera 20% të vlerës së mbetur.

#### **4.6 Aktivet afatgjata jomateriale**

Një aktiv afatgjatë jomaterial (AAJM) njihet vetëm nëse: është e mundur që të ketë përfitime të ardhshme ekonomike, kostoja e aktivit mund të matet me besueshmëri dhe aktivin nuk është rezultat i shpenzimeve të bëra brenda shoqërisë për një zë jomaterial. Njohja fillestare e një aktiv jomaterial bëhet me kosto, ndërsa vlerësimi i mëpasshëm paraqitet me koston e tij minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

#### **4.7 Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve**

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Matja e të ardhurave bëhet me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme. Vlera e drejtë e shumës së arkëtuar apo për t'u arkëtuar merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe e produkteve njihen kur janë plotësuar të gjitha kushtet e mëposhtme: i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, që lidhen me pronësinë e mallrave dhe produkteve; shoqëria nuk vazhdon të jetë e përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në menaxhimin e mallrave dhe të produkteve në atë masë që tregon se ende zotëron titullin e pronësisë dhe/ose ka kontroll efektiv mbi mallrat/produktet e shitura; shumën e të ardhurave mund të matet me besueshmëri; është e mundur që përfitimet ekonomike, që lidhen me transaksionin, do të merren; kostot që kanë ndodhur, ose që do të ndodhin në lidhje me transaksionin, mund të maten me besueshmëri.

Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen kur: shumën e të ardhurave mund të matet me besueshmëri; është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të hyjnë në shoqëri; faza e përfundimit të transaksionit në fund të periudhës raportuese mund të matet me besueshmëri; kostot e ndodhura për shërbimin, si dhe ato që do të ndodhin për përfundimin e tij mund të maten me besueshmëri.

Të ardhurat që rrjedhin nga përdorimi nga palë të treta i aktiveve të saj që sjellin interes, përfitim pagesash për përdorime të pronës (rojëliti) dhe dividendë njihen si më poshtë: të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e metodës lineare ose të metodës së bazuar në normën e brendshme të interesit efektiv; të ardhurat nga shfrytëzimi i pronësisë (rojëliti) njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, në përputhje me kushtet e kontratës; të ardhurat nga dividendët njihen kur aksionari ka të drejtë ligjore për ta arkëtuar atë (dividendin).

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria zbaton parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtit ushtrim kontabël. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre, pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar.

#### **4.8 Transaksionet me monedhat e huaja**

Transaksionet në monedhë të huaj, që plotësojnë kushtet në njohje, regjistrohet në monedhën funksionale, duke zbatuar mbi shumën e monedhës së huaj kursin e menjëhershëm të këmbimit (spot) ndërmjet monedhës funksionale dhe monedhës së huaj në datën e transaksionit, por shpesh përdoret një kurs këmbimi, i cili është i përafërt me kursin e datës së kryerjes së transaksionit, p.sh. një kurs mesatar i një jave ose një muaji mund të përdoret për të gjitha transaksionet e kryera gjatë kësaj periudhe, në secilën prej monedhave të përdorura.

Në fund të çdo periudhe raportuese, zërat në monedhë të huaj përkthehen si më poshtë: zërat monetarë të shprehur në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit të mbylljes (d.m.th. në datën raportuese); zërat jomonetarë që maten me kosto historike në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit; zërat jomonetarë që maten me vlerën e drejtë në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Diferencat e këmbimit, që krijohen gjatë shlyerjes së zërave monetarë ose gjatë përkthimit të zërave monetarë me kurse këmbimi të ndryshme nga kurset e këmbimit, me të cilat ato janë përkthyer në njohjen gjatë periudhës kontabël aktuale, ose në pasqyrat financiare të mëparshme, njihen si fitim (ose humbje) të periudhës kontabël

kur ato linden. Kur një përfitim ose humbje për një zë jomonetar njihet drejtpërdrejt në kapital, atëherë drejtpërdrejt në kapital do të njihet edhe diferenca e këmbimit.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2021 janë 1 euro=120.760 leke dhe 1 dollar=106.54 leke.

#### 4.9 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet si shpenzim tatimor në pasqyrën e performancës, përveç tatimit të zërave që njihen direkt në kapital, i cili njihet si një zë i kapitalit.

Detyrimi tatimor aktual njihet në vlerat që shoqëria pritet të paguajë (rimbursojë) mbi bazën e normave tatimore dhe ligjeve tatimore që janë miratuar ose janë në thelb të miratuara në datën e raportimit.

Aktivi ose detyrimi tatimor të shtyrë njihet për tatimet e zbritshme (rimbursueshme) ose të pagueshme në periudhat e ardhshme si rezultat i transaksioneve ose ngjarjeve të kaluara. Këto tatime linden nga ndryshimet mes vlerave të njohura për aktivet dhe detyrimet në pasqyrën e pozicionit financiar dhe njohjes së këtyre aktiveve dhe detyrimeve nga autoritetet tatimore, si dhe nga mbartja e humbjeve tatimore dhe e tatimit të zbritshëm (rimbursueshëm) të papërdorur.

Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për ushtrimin 2021 është 15 % aq sa ka qënë në ushtrimin e mëparshëm.

#### Informacion mbështetës për zërat e paraqitur në pasqyrat financiare, në rendin në të cilin paraqitet çdo pasqyrë dhe zë përkatës

#### 5. Mjete Monetare (likuiditete në arke, bankë etj.)

Gjendjet e mjetet monetare në banke dhe arke, në fillim dhe fund të ushtrimit janë si më poshtë:

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Monedha	Viti raportues 31.12.2021		Viti paraardhës 31.12.2020	
			Leke	Valute	Leke	Valute
1	Mjete monetare në arkë	Lekë	8,061,981	-	4,802,352	-
2	Mjete monetare në bankë	Lekë/Euro/	6,722,460	-	4,995,311	-
.....	.....					
3	Investime në tregje shumë likuide	Lekë	-	-	-	-
<b>Shuma</b>			<b>14,784,441</b>	<b>-</b>	<b>9,797,663</b>	<b>-</b>

Gjendjet e llogarive të likuiditeteve të paraqitura në pasqyrat financiare konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike të monedhave në fund të ushtrimit. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, janë përkthyer në leke duke përdorur kursin e këmbimit të shpallur nga B.Shqipërisë.

#### 6. Të Drejta të Arkëtueshme Afatshkurtëra

Të drejtat e arkëtueshme, në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabël deklarohen si vijon:

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Viti Raportues 31.12.2021		Viti Paraardhës 31.12.2020	
1	Nga Aktiviteti i Shfrytëzimit(Kliente)	36,751,160		44,617,666	
2	Njësitë Ekonomike Brenda Grupit	-		-	
3	Interesa Pjesëmarrëse në Njësi Ekonomike	-		-	
4	Të Tjera (Debitore të tjerë)				
	Shteti-Tatimi aktual mbi fitimin	2,251,677		-	
	Shteti-Tatim mbi vlerën e shtuar	190,486		2,000,855	
	Huadhenie e përkoshme	-		-	
	Te tjera	-		1,941,164	
5	Kapital i Nënshkruar i Papaguar	-		-	
<b>Shuma</b>		<b>39,193,323</b>		<b>48,559,685</b>	

Në “Nga Aktiviteti i Shfrytezimit(Kliente)” rezulton me gjendje ne fund te ushtrimit.

Në “Të Tjera (Debitore të tjerë)” jane pasqyruar kërkesat debitore ndaj tatim taksave për tatimin mbi vleren e shtuar, dhe tatimin mbi fitimin.

Drejtimi mendon se të gjitha kërkesat do të arketohen në një periudhë afatshkurter me vleren e tyre nominale dhe nuk parashikon rënie në vlerë.

## 7. Inventari

Gjendjet e inventarit ne fillim dhe fund te ushtrimit paraqiten:

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Viti Raportues 31.12.2021	Viti Paraardhës 31.12.2020
1	Lënde e Parë dhe Materiale të Konsumueshme	-	2,771,536
2	Prodhime në Proces dhe Gjysëmprodukte	-	-
3	Produkte të Gatshme	-	-
4	Mallra	-	-
5	Aktive Biologjike	-	-
6	AAM të Mbajtura për Shitje	-	-
7	Parapagime për Inventar	-	-
<b>Shuma</b>		-	<b>2,771,536</b>

Vlerat e inventarit te paraqitura me sipër perputhen me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike e kryer ne fund te ushtrimit 2021. Veprimet ekonomike qe lidhen me hyrjet e daljet jane tranzituar ne llogarite e rezultatit me menyren e inventarit te perhershem. Shuma e inventarit te paraqitur ne "Mallra per rishitje" perfaqeson stokun e mallrave dhe materialeve qe do te tregtohen, te vleresuara me kostot mesatare te blerjes. Drejtimi mendon se vlera e paraqitur eshte vlera me e ulet mes kosos se marrjes dhe vleres neto te realizueshme dhe nuk eshte nevoja per zhvleresime te tij.

## 8. Shpenzime të Shtyra

Nuk jane evidentuar shpenzime te shtyra ne fund te ushtrimit.

## 9. Aktivet Afatgjata Materiale(AAM-te)

Kostoja, amortizimi i akumuluar dhe vlera kontabël në fillim dhe në fund të vitit ushtrimit për aktivet afatgjata materiale(AAM-të) paraqiten si vijon:

Nr	Gjendjet dhe levizjet	Toka/Terrane	Ndentesa	Impiante dhe makineri	Te tjera instalime dhe pajisje	Parapagime për Aktive Materiale dhe në Proces	Totali
A	Kosto e AAM-ve 01.01.2021	-	-	-	519,113	-	519,113
	Shtesat	-	-	-	-	-	-
	Pakësimet	-	-	-	(166,667)	-	(166,667)
	Kosto e AAM-ve 31.12.2021	-	-	-	352,446	-	352,446
B	Amortizimi AAM-ve 01.01.2021	-	-	-	(54,197)	-	(54,197)
	Amortizimi ushtrimit	-	-	-	(74,030)	-	(74,030)
	Amortizimi për daljet e AAM-ve	-	-	-	21,481	-	21,481
	Amortizimi AAM-ve 31.12.2021	-	-	-	(106,746)	-	(106,746)
C	Zhvlerësimi AAM-ve 01.01.2021	-	-	-	-	-	-
	Shtesat	-	-	-	-	-	-
	Pakësimet	-	-	-	-	-	-
	Zhvlerësimi AAM-ve 31.12.2021	-	-	-	-	-	-
D	Vlera neto e AAM-ve 01.01.2021	-	-	-	464,916	-	464,916
E	Vlera neto e AAM-ve 31.12.2021	-	-	-	245,700	-	245,700

AAM-të, që plotësojnë kriteret për njohje si aktiv në pasqyrën e pozicionit financiar, janë matur me kosto. Në vlerësimin e mëpasshëm shoqëria zbaton si politikë të saj kontabël modelin e koston dhe në pasqyrën e pozicionit financiar AAM-të janë paraqitur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka.

Vlerat dhe klasifikimi ne grupe i AAM-ve te pasqyruara ne bilanc dhe ne tabelen e mesiperme jane te perputhura me te dhenat e inventarizimeve fizike qe shoqeria e ka kryer ne fund te muajit dhjetor 2021.

Metoda e zgjedhur e amortizimit të AAM-ve është metoda mbi vlerën e mbetur, e njëjtë me atë që përdoret për qellime fiskale.

Shoqëria vlerëson në çdo datë të raportimit nëse ka ndonjë shenjë që një aktiv mund të jetë i zhvlerësuar. Drejtimi mendon se përgjithësisht në këtë ushtrim kontabël, nuk ka shenja të rënjes në vlerë të AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvleresime.

#### 10. Detyrime Afatshkurtëra

Detyrimet afatshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2021 paraqiten:

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Viti Raportues 31.12.2021	Viti Paraardhës 31.12.2020
1	Titujt e Huamarrjes	-	-
2	Detyrime ndaj Institucioneve të Kredisë	-	-
3	Arkëtime në Avancë për Porosi	-	-
4	Të Pagueshme për Aktivitetin e Shfrytëzimit(furnitore)	9,444,875	4,594,200
5	Dëftesa të Pagueshme	-	-
6	Të Pagueshme ndaj Njës.Ekon. Grup	-	-
7	Të Pagueshme ndaj Njës.Ekon. Pjesëmarrje	-	-
8	Të Pagueshme ndaj Punonjësve dhe Sigurime shoq./shëndet.	-	-
	Paga dhe shpërblime	1,171,017	595,764
	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	20,925	60,435
9	Të Pagueshme për Detyrime Tatimore	-	-
	Shteti-Tatim aktual mbi fitimin	-	-
	Shteti-Tatim mbi vlerën e shtuar	-	-
	Tatim mbi të ardhurat personale	1,950	1,152,614
	Tatimi ne burim	-	10,976
10	Të Tjera të Pagueshme	29,675,516	29,772,250
	<b>Shuma</b>	<b>40,314,283</b>	<b>36,186,239</b>

“Të Pagueshme për Aktivitetin e Shfrytëzimit(furnitore)” ne shumen 9.444.875 leke pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve per blerje mallra e sherbime, te cilat jane te palikujduara ne fund te ushtrimit.

“Të Pagueshme ndaj Punonjësve dhe Sigurime shoq./shëndet.” paraqet detyrimet e mbetura pa u paguar ndaj personelit dhe detyrimin e muajit dhjetor 2021.

“Të Pagueshme për Detyrime Tatimore “ perbehet nga detyrimi per tatimin mbi te ardhurat personale i muajit te fundit qe do te paguhet ne janar 2022. “Të tjera të pagueshme” perbehet nga hua te marra nga subjekti.

#### 11. Detyrimet Afatgjata

Nuk jane evidentuar detyrime afatgjata ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel.

#### 12. Kapitali dhe rezervat

Kapitali i regjistruar i shoqerisë, i paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar, është i njëjtë me atë të percaktuar ne statutin e shoqerise dhe vendimet e depozituara ne QKR. Me 31.12.2021.

Fitimi i vitit ushtrimor 2020, me vendim të ortakeve, është bere shperndarje (terheqje) dividenti ne shumen 2.556.656 leke, po ashtu ne shumen 7.443.344 leke eshte bere shperndarje (terheqje) dividenti nga fitimet e pa shperndara te mbartura.

Gjate ushtrimit kontabël nuk ka rritje ose pakesim ne kapitalin e regjistruar të shoqerisë dhe ndryshime ne raportet zoterimit nga ortakët.

**13. Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit dhe të tjera**

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit dhe të tjera paraqiten si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti Raportues 31.12.2021	Viti Paraardhës 31.12.2020
<b>1</b>	<b>Të Ardhura nga Aktiviteti i Shfrytëzimit:</b>		
	Shitje e produkteve te gatëshme dhe nënprodukteve	5,552,650	94,368,655
	Shitja e punimeve dhe shërbimeve	-	-
	Shitja e mallrave	-	-
	Të ardhura nga shitje të tjera(qera, komisione, etj)	-	-
	<b>Totali i të Ardhura nga Aktiviteti i Shfrytëzimit</b>	<b>5,552,650</b>	<b>94,368,655</b>
<b>2</b>	<b>Puna e Kryer nga Nj.E dhe e kapitalizuar</b>	-	-
<b>3</b>	<b>Të Ardhura të Tjera të Shfrytëzimit</b>		
	Të ardhura nga Shitja e Aktiveve Afategjate	429,100	6,914,305
	Të ardhura të tjera(grantet, te tjera,.....)	-	-
	<b>Shuma</b>	<b>5,981,750</b>	<b>101,282,960</b>

Te ardhurat nga shitja e mallrave perfaqesojne shitjen e mallrave qe jane vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara, te zhveshura nga TVSH-ja.

**14. Shpenzimet për lëndë të parë dhe materiale të konsumueshme**

Shpenzimet per lenden e pare dhe materiale te konsumueshme per vitin 2021 paraqiten si me poshte Ato jane paraqitur ne zërin përkaates te pasqyres se performances.

Nr	Emertimi	Viti Raportues 31.12.2021	Viti Paraardhës 31.12.2020
<b>1</b>	<b>Ndryshimi në Inventarin e PG&amp;PP</b>	-	-
<b>2</b>	<b>Lënda e Parë dhe Materiale të Konsumueshme</b>		
	Lënda e Parë dhe Materiale	-	-
	Mallra	5,037,771	81,098,515
	Energji, uje	-	-
<b>3</b>	<b>Të Tjera Shpenzime</b>	-	-
	<b>Shuma</b>	<b>5,037,771</b>	<b>81,098,515</b>

Si politike kontabel ne percaktimin e kosos se inventarit eshte perdorur metoda "mesatares se ponderuar". Vlera e inventarëve të njohura si shpenzim gjatë periudhës kontabël 2021 eshte 5.037.771 leke.

**15. Shpenzime personeli**

Shpenzimet e personelit përbehen nga pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, leja vjetore e paguar, raporti mjekësor i paguar në 14 ditët e para, pjesëmarrja në fitime dhe shpërblimet. Numri mesatar i punonjesve dhe shpenzimet vjetore të kryera për personelin janë si me poshtë :

Nr		Viti Raportues 31.12.2021	Viti Paraardhës 31.12.2020
<b>1</b>	<b>Shpenzime Personeli</b>		
	Paga dhe Shpërblime	1,007,216	3,454,713
	Shpenzime për Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	168,205	576,937
	Të tjera	-	-
	<b>Shuma</b>	<b>1,175,421</b>	<b>4,031,650</b>
<b>2</b>	<b>Numri mesatar vjetor i të punësuarve</b>	<b>2</b>	<b>8</b>

**16. Shpenzime të tjera shfrytëzimi**

Në shpenzime të tjera të shfrytëzimit janë përfshirë kostot e shërbimeve kryesore dhe ndihmëse, që lidhen drejtpërdrejt me veprimtaritë e shfrytëzimit dhe ato për qëllime administrative, si dhe, kostot që ndodhin jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të biznesit.

Nr	Emertimi	Viti Raportues 31.12.2021	Viti Paraardhës 31.12.2020
<b>I</b>	<b>Të Tjera Shpenzime</b>		
<b>1</b>	<b>Shërbime nga të tretët(Ilog.61-62)</b>		
	Trajtime të përgjithshme(nga te trete)	1,159,488	486,383
	Qera	50,000	2,003,316
	Mirmbajtje dhe riparime	-	251,622
	Sigurime	-	28,785
	Publicitet, reklama		
	Trasferime, udhëtime, dieta		-
	Shpenzime postare dhe telekomunikimi	5,124	55,529
	Shpenzime për shërbimet bankare	41,957	162,330
	Të tjera	30,000	1,515,518
<b>3</b>	<b>Tatime dhe taksa(Ilog.63)</b>		
	Taksa dhe tarifa vendore	82,000	95,120
	Taksa te regjistrimit		-
	Tatime te tjera	4,800	92,204
<b>4</b>	<b>Shpenzime të tjera jo korrente(Ilog.67)</b>		
	Vlera kontabël e AA te shitura	145,186	6,974,546
	Te tjera		-
<b>5</b>	<b>Shpenzime të Tjera Shfrytëzimi(Gjoba,provizione) Llog.65,68)</b>		
	Shpenzime per pritje dhe përfaqësime		-
	Gjoba dëmshpërblime	3,992	110,807
	Provizione	-	-
	Te tjera	-	-
	<b>Shuma</b>	<b>1,522,547</b>	<b>11,776,160</b>

**17. Te ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Jane paraqitur si diference e te ardhurave me shpenzimet sipas kerkesave te standarteve.

Në "Interesa të Arketueshem dhe të Ardhura të Tjera të Ngjashme" në shumë 329.639 leke pasqyrojne Fitime nga këmbimet dhe përkthimet valutore.

**18. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin**

Ne vijim janë pasqyruar përbërësit më kryesorë të shpenzimeve (të ardhurave) tatimore të cilat përfshijnë: shpenzimet tatimore aktuale dhe shumën e shpenzimit (të ardhurës) tatimore të shtyrë, që ka të bëjë me krijimin dhe realizimin e diferencave të përkohshme dhe mbartjen e humbjeve.



Nr.	Emertimi	Viti Raportues 31.12.2021	Viti Paraardhës 31.12.2020
<b>I Shpenzimi Aktual i Tatimit mbi Fitimin</b>			
1	Fitimi/(Humbja) Para Tatimit	(1,498,380)	3,027,385
2	Të ardhura të njohura që përjashtohen nga tatimi mbi fitimin(-) Dividentët e deklaruar dhe ndarjet e fitimit(nga investimet e kontrollit dhe Të tjera(rimarrje provizionesh,gjobash etj)(-)	-	-
3	Shpenzime të panjohura tatimore(+) Shpezime pritje e dhurime tej kufirit tatimor(+) Gjoha,penalitete,demshperblime(+) Amortizim mbi normat fiskale(+) Provizione per rreziqe e shpenzime(+) Të tjera	3,992 - 3,992 - - -	110,807 - 110,807 - - -
4	Diferenca pozitive- Shpenzimet tatimore të lejuara minus njohjet për qëllimet e raportimit(-) Amortizimi i përshpejtuar tatimor(-) Të tjera(-)	- - -	- - -
5	Zbritja e humbjes tatimore(-)	-	-
6	Fitimi i Tatueshëm(1+2+3+4+5)	<b>(1,494,388)</b>	<b>3,138,192</b>
Shpenzimi Aktual i Tatimit mbi Fitimin(2021-15%)		-	(470,729)
<b>II Shpenzim(të ardhura) i Tatim Fitimit të Shtyrë(+/-)</b>			
III Shpenzime(të ardhura) për Tatimin mbi Fitimin(I+II)		-	(470,729)
Fitimi/(Humbja) e Vitit Financiar		<b>(1,498,380)</b>	<b>2,556,656</b>

Në llogaritjen e shpenzimit aktual të tatimit mbi fitiminjane respektuar kerkesat e legjislacionit fiskal.Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2021 eshte 15%.

Nuk jane identifikikuar aktive, detyrimeve dhe zërave të zjerë që priten të ndikojnë në fitimin e tatueshëm nëse ato do të realizoheshin ose shlyheshin me vlerat e tyre kontabël aktuale, që ka të bëjë me krijimin dhe realizimin e diferencave të përkohshme.Per rrjedhim nuk eshte njohur asnjë tatim fitimi i shtyrë.

**Shënime të tjera shpjeguese**

**19. Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit**

Asnjë ngjarje e rëndesishme nuk ka ndodhur pas datës së miratimit të pasqyrave financiare.

**20. Shpjegime mbi palët e lidhura**

Me marrjen në konsiderate të çdo transaksioni dhe marredhenie të mundeshme, jo thjesht formen ligjore të tyre ne 31 Dhjetor 2021 dhe 31 Dhjetor 2020 nuk ka transaksione me palët e lidhura.

**21. Shifrat krahasuese**

Pasqyrat financiare të vitit 2021 janë hartuar dhe paraqitur në përputhje me formatet që janë dhënë në shtojcën e standardit SKK-2, (të përmirësuar) dhe çeljet e vitit paraardhes janë riparaqitur sipas këtyre zërave.